



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:202162

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05392618

P.nr.1290/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me bashkëpunëtoren profesionale Arbnijë Gashi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit, A.B., nga Prizreni, rruga ‘.....’ pn, për shkak të veprës penale, Mashtrimi, nga neni 323 par.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës-KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti përgjithshëm PP/II.nr.1272-13/2023 të datës 05.12.2023, në shqyrtimin fillestar në seancë publike të mbajtur më datën 25.01.2024 sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në prani të prokurorit të shtetit Beqë Shala, të dëmtuarit Sh.R., të akuzuarit A.B., dhe mbrojtësit së tij av.Z.S., me datë 25.01.2024 shpalli, ndërsa me datë 26.02 shtator 2023 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari

A.B., nga i ati dhe e ëma, e gjinisë, i lindur me datë, në Prizren, me banim në rrugën “.....” pn, i martuar, i ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollimin e mesëm, tregtarë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Nga data 11.11.2020 deri me datë 25.10.2021, në kohë të pa përcaktuar saktë, në Prizren, i pandehuri A.B., me anë të paraqitjes së rreme të fakteve, e mashtron të dëmtuarin Sh.R., duke e vënë në lajthim, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veti, në atë mënyrë që, manipulon në numrin e kilometrave të kaluara me qëllim që të rritjes së vlerës të veturës në treg, duke bërë ndryshimin në numrin e kilometrave të kaluara të automjetit me nr. të karrocërisë WDD....., ashtu që i njëjti automjet gjatë kontrollimit teknik të datës 11.11.2020 të bërë nga pronari paraprak, automjeti kishte numrin e kilometrave 299275 KM, ndërsa në kontrollimin teknik të datës 25.10.2021 të bërë nga i dëmtuari Sh.R., i cili e kishte blerë të njëjtën veturë nga i pandehuri, vetura e cekur rezulton me numrin e kilometrave 232728, që do të thotë se veturës i janë zbritur gjithsej 66547 KM dhe me këtë gjendje me këto kilometra të zbritura ia shet automjetin të dëmtuarit Sh.R., me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton dëm material.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, Mashtrimi nga neni 323 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-074.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 38, 39,40, 42, 43, 44 dhe 69 të KPRK-së, si dhe në kuptim të nenit 230 dhe 364 të par. 1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej treqind (300) euro, të cilën shumë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 1 dite burgim me 20 euro, gjegjësisht 15 ditë burgim.

Dhe ,

DËNIMIN ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej tre (3) muajve.

Me pëlqimin e të akuzuarit, e në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burgim, shëndërrohet në dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro, të cilën shumë është i obliguar ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të nenit 76 par.2 nën par. 2.4, lidhur me par 1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM UNIK ME GJOBË

Në shumë prej tetëqind (800) euro, të cilën shumë është i obliguar ta paguaj, e cila shumë i mundësohet ta paguaj me këste mujore nga dyqind (200) euro çdo muaj. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 1 ditë burgim me 20 euro, gjegjësisht 40 ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në llogari të gjykatës, për paushallin gjyqësor shumë prej njëzet (20) euro dhe në emër të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) euro të gjitha këto në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të dëmtuarin Sh.R.,n nga fshati Lloshkobare, Komuna e Ferizajt, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e udhëzon në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, kësaj Gjykate ia ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1272-13/2023 të datës 05.12.2023, ndaj të akuzuarit, A.B., nga Prizreni, rruga ‘A..... ’ pn, për shkak të veprës penale, Mashtrimi, nga neni 323 par.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës-KPRK-së. Së bashku me aktakuzë kanë parashtruar edhe marrëveshjen me shkrim për pranimin e fajësisë.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 25.01.2024.

I akuzuari A.B., edhe gjatë seancës e ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë nën kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Sa i përket gjendjes faktike gjykata e ka vërtetuar ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrethanat ligjore të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Gjykata në këtë seancë nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe sipas kushteve të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, e në raport me provave materiale të bashkangjitura kësaj aktakuze si: deklarata e të pandehurit A.B., e dhënë në prokurori me datë 27.11.2023, si dhe në polici me datë 20.06.2023, deklarata e të dëmtuarit Sh.R., e dhënë në prokurori me datë 18.10.2023 si dhe në polici me datë 15.05.2023, deklarata e dëshmitarit L.S., të dhënë në polici me datë 22.05.2023, deklaratës së dëshmitarit H.M., të dhënë në polici me datë 24.05.2023, libreza e automjetit CRA nr. 05-341-FT, të dhënat mbi verifikimin e kilometrave të automjetit me nr. karrocërisë WDD....., gjatë kontrollit në vitin 2020 në Gjakovë dhe kontrollimi gjatë vitit 2021 në Ferizaj, foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera në lëndë, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prokurori i shtetit ka theksuar se marrëveshja e arritur është bërë konform dispozitave të KPP-së andaj propozoi që kjo marrëveshje nga ana e gjykatës të pranohet, dhe të pandehurit në rastin konkret ti shqiptohet dënimi i rekomanduar sipas marrëveshjes.

I dëmtuari Sh.R., ka deklaruar, se realizimin e dëmit lidhur me këtë çështje penale do ta realizoj në procedurë kontestimore.

Mbrojtësit i të pandehurit Z.S., , ka theksuar se në tërësi pajtohet me kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, të cilën e kane arritur së bashku me prokurorin dhe se marrëveshja është lidhur me pëlqimin e të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme. Duke kërkuar nga gjykata, që konformë dispozitave të KP-së, të aprovoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

I akuzuari A.B., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën e prokurorisë së shtetit dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, e pranon fajësinë për veprën penale, Mashtrimi nga neni 323 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjithashtu ka deklaruar se e ka kuptuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të cilën e ka lidhur me vullnet të lire, pa shtrëngim kanosje apo presion si dhe e pranon dënimin e arritur në atë marrëveshje.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit A.B., formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale, Mashtrimi, nga neni 323 par.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale-juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënit. Gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë që në fazat e hershme të procedurës, keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari si dhe rrethanat personale se është i gjendjes së dobët ekonomike. Ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e lartë të përgjegjësisë së personit të dënuar për veprën penale në fjalë dhe dashjës së tij, ngase me vetëdije të plotë ka manipuluar me kilometrat e veturës në fjalë, nga këto rrethana gjykata ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në tërësi me të gjitha

pikat e saja, me ç'rast të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjyimit duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 në lidhje me nenin 451 të KPP-së

Vendimi mbi pagesën e taksës në emër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartcekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
Departamenti përgjithshëm
P.nr.1290/2023 më datë 26 shkurt 2024

Gjyqtari
Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh prej ditës së pranimit të kopjes së aktgjyimit, Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.